

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit J. A. nga fshati L. Komuna e Prizrenit, për shkak të dy veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2229/2014 të datës 09.10.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Beqë Shala, të akuzuarit dhe përkthyesit të gjykatës Asnije Berisha, me datë 20.01.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

J. A. nga i ati A. dhe e ëma B. e lindur V., i lindur më datë *data e lindjes....* në Prizren, tani me banim në fshatin L. Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën e mesme, student, i pa martuar, me numër personal *numri personal....*, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

1. Me datë 17.09.2014 në orët e hershme të mëngjesit rreth orës 03:30 minuta, në fshatin L. Komuna e Prizrenit, i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin e dëmtuarit Xh. K., pasi që ka dyshuar se i dëmtuari ka montuar kamerë për ta përcjellë atë, fillimisht drejtohet me fjalë “ma jep aparatën se të mbys” e pastaj e godet me një thikë – mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor – dëmtimit të rëndë të shëndetit, e godet në pjesë të ndryshme të trupit, me ç’rast i shkakton plagë shqyese e ndrydhëse në kokë, plagë shqyese e ndrydhëse në dorën e djathtë dhe gërvishje në kofshën e majtë, të cilat kanë karakter të lëndimit të lehtë trupor, me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPK.

2. Me datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin nën **1.** të aktgjykimit, për shkak të ngatërresave me të dëmtuarin i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin e dëmtuarës E. K., në atë mënyrë që hynë në oborrin e dëmtuarës e godet me një dru – mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor – dëmtimit të rëndë të shëndetit, ashtu që e godet në pjesën e shpinës dhe i shkakton ndrydhje të indeve të buta të shpinës të cilat kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPK të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Për veprën penale nën **1.** të dispozitivit të aktgjykimit i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve dhe për veprën penale nën **2.** të dispozitivit të aktgjykimit i shqipton dënimin me burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve.

Në kuptim të nenit 80 par.1 e nenit 51 të KPK, vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprën të re penale.

Të dëmtuarit Xh. K. dhe E. K. që të dy nga fshati L. Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues në kuptim të nenit 69 par.1 të KPK i merret thika, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, pasi që i akuzuari për shkak të gjendjes së dobët shëndetësore është i pa punë – është i gjendjes së varfër ekonomike, prandaj lirohet nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore sepse pagesa e tyre do të rrezikon gjendjen material të akuzuarit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2229/2014 të datës 09.10.2014, kundër të akuzuarit J. A. nga fshati L. Komuna e Prizrenit, për shkak të dy veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPK.

Në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari deklaroj se nuk e kundërshton asnjë provë në të cilën mbështetet aktakuza, andaj në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë për veprat penale me të cilat ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 17.09.2014 në orët e hershme të mëngjesit rreth orës 03:30 minuta, në fshatin L. Komuna e Prizrenit, i akuzuari J. A., për shkak të mosmarrëveshjes që ka pasur me komshinjtë e tij për shkak të dyshimit se të njëjtit po përcjellin me kamera, fillimisht i afrohet shtëpisë së dëmtuarve dhe ia tërheqë vërejtjen të dëmtuarit Xh. K.. Mirëpo si rezultat i raporteve jo të mira në mes tyre i akuzuari drejtohet me fjalë “ma jep aparatën se të mbys” ku më pas fillon edhe përleshja mes tyre, me ç’rast i akuzuari sulmon fizikisht të dëmtuarin Xh. K. e godet me një thikë – mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor e godet në pjesë të ndryshme të trupit, me ç’rast i shkaktin plagë shqyese e ndrydhëse në kokë, plagë shqyese e ndrydhëse në dorën e djathë dhe gërvishtje në kofshën e majtë. Konflikti mes tyre vazhdon për shkak të gjendjes së tendosur në mes tyre, me ç’rast i akuzuari depërton në oborrin e dëmtuarve dhe me një dru – mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor e sulmon edhe të

dëmtuarën E. K., ashtu që e godet në pjesën e shpinës dhe i shkakton ndrydhje të indeve të buta të shpinës të cilat kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar në shqyrtimin fillestar ku i akuzuari vullnetarisht ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Mirëpo sipas detyrës zyrtare nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprat penale të cilat iu vihen në barrë të cilat mbështeten në fakte dhe prova materiale, të paraqitura në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 246 të KPPK dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPK dhe për këtë të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kusht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, rrethanat familjare, është i pa punë, jeton me prindërit që do të thotë se shpenzimet e tij rreth shkollimit e mbulojnë prindërit, pendimi i thellë për kryerjen e veprave penale, premtimin se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla, kjo është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht, sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Vendimi mbi dënimin plotësues marrja e sendit është marrë në pajtim me nenin 69 par.1 të KPK.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarve në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të KPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të KPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1541/2014 të datës 20.01.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.